

University for Business and Technology in Kosovo

UBT Knowledge Center

Theses and Dissertations

Student Work

Spring 6-2010

Diplomacia multilaterale dhe çështja e Kosovës

Lejla Kolenović

University for Business and Technology - UBT

Follow this and additional works at: <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd>



Part of the [Law Commons](#)

Recommended Citation

Kolenović, Lejla, "Diplomacia multilaterale dhe çështja e Kosovës" (2010). *Theses and Dissertations*. 403.
<https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd/403>

This Thesis is brought to you for free and open access by the Student Work at UBT Knowledge Center. It has been accepted for inclusion in Theses and Dissertations by an authorized administrator of UBT Knowledge Center. For more information, please contact knowledge.center@ubt-uni.net.



Fakulteti i Drejtësisë, Shkencave Politike dhe Diplomacisë

Diplomacia multilaterale dhe çështja e Kosovës
Shkalla Bachelor

Lejla Kolenović

Qershor / 2010
Prishtinë



Fakulteti i Drejtësisë, Shkencave Politike dhe Diplomacisë

**Punim Diplome
Viti Akademik 2006/2007**

Studentja: Lejla Kolenović

Diplomacia multilaterale dhe çështja e Kosovës

Mentori: Prof. Dr. iur. Eqrem Zenelaj

Qershor 2010

Ky punim është përpiluar dhe dorëzuar në përmbushjen e kërkesave të
pjeshme për Shkallën Bachelor

PËRMBAJTA:

ABSTRAKTI

1. HYRJE	5
2. POZITA E KOSOVËS BRENDË FEDERATËS JUGOSLLAVE	7
2.1 PËRMIRËSIM STATUSI.....	8
2.2 DEMONSTRATAT E VITEVE '80 – SHKELJET E PARA TË TË DREJTAVE TË NJERIUT	8
3. SHPËRBËRJA E JUGOSLLAVISË	11
3.1 PAS SHPËRBËRJES SË JUGOSLLAVISË DHE PAS PËRFUNDIMIT TË LUFTËS NË BOSNJE.....	16
3.2 PERIUDHA 1997-1998	19
4. VITI 1999	29
4.1 KONFERENCA E RAMBUJESË	32
4.2 KONFLIKTI NË HORIZONT	34
4.3 ÇLIRIMI I KOSOVËS.....	35
5. ADMINISTRIMI NDËRKOMBËTAR NË KOSOVË.....	36
5.1 STATUSI SI ZGJIDHJE E VETME QËNDRUESHME	38
5.2 BASHKËSIA NDËRKOMBËTARE NË PRITJE TË PAVARËSISË SË KOSOVËS	39
6. SHPALLJA E PAVARËSISË	40
7. DESTINACION I FUNDIT – INTEGRIMET EVROPIANE DHE DIPLOMACIA KOSOVARE	42
8. L I T E R A T U R A	43

ABSTRAKTI

Qëllimi i punimit mbi rolin e Diplomacisë multilaterale në Kosovë është elaborimi rreth përfshirjes e bashkësisë ndërkombëtare në forma të organizuara rreth organizatave ndërkombëtare dhe rolin e diplomacive të shteteve anëtare dhe qëndrimet e tyre. Studimi në fjalë ka rëndësi të veçantë për shkak të momentit politik në të cilin gjindet Kosova në prag të shpalljes së vendimit të Gjykatës ndërkombëtare të drejtësisë mbi shpalljen e pavarësisë së Kosovës në shkurt të vitit 2008.

Në këtë punim në mënyrë të përgjithshme do të shqyrtohet përfshirja e organizatave ndërkombëtare në zgjidhjen e qështjes së Kosovës në menyrë kronologjike duke filluar me ngjarjet të cilat kanë rezultuar me miratimin e Kushtetutës RFSJ-së së vitit 1974; represaljet e para të cilat shkaktuan proteste të viteve '80; shpërbërjen e Jugosllavisë; konfliktin e vitit 1999; intervenimin e NATO-së; administrimin ndërkombëtarë; shpalljen e pavarësisë dhe rrugën e Kosovës drejt integritit në familjen europiane.

Punimi e paraqet angazhimin dhe ndërhyrjen e organizatave ndërkombëtare dhe ndërrimin e rolit të tyre mvarësisht nga faza në të cilën gjindej Kosova. Në menyrë gjithëpërfshirëse paraqitet rruga e Kosovës nga periudha e shkeljes masive të drejtave të njeriut në Kosovë deri te ndërtimi i shtetit dhe shpallja e pavarësisë të gjitha këto nën vëzhgimin e afërt dhe ndërhyrje të organizatave ndërkombëtare si dhe zëvendësimin e veprimëtarisë së tyre me angazhimin e diplomacisë së re të Kosovës.

1. HYRJE

Çdo ditë e më shumë në shekullin XXI forumet kryesore për aktivitete diplomatike nuk janë më takime bilaterale mes diplomatëve të dy shteteve por mund të vërehet zhvendosja e fokusit tek organizatat multilaterale, në konferencat e të cilave ndodhin ngjarjet kryesore në marrëdhëniet ndërkombëtare.

Që nga vitet '80 por edhe me herët kur u vunë re problemet e para në Ballkan ishte hera e parë që organizatat ndërkombëtare shfaqen interesim për Ballkanin dhe ngjarjet që e tronditen gjithë Evropën.

Angazhimi dhe përfshirja e organizatave multilaterale në ngjarjet e Kosovës vërehet që nga vitet '90-ta. Kompleksiteti i marrëdhënieve ndër-etnike në kontekstin historik të Kosovës e bëri të nevojshme përfshirjen e palës të jashtme, në këtë rast organizatave multilaterale, në kërkimin e zgjedhjes optimale dhe gjithëpranueshme.

Ky punim do të trajtojë natyrën e përfshirjes së organizatave ndërkombëtare në ngjarje të ndryshme të paraqitura në mënyrë kronologjike. Gjithashtu do të paraqitet qendrimi i tyre në faza të ndryshme të problemit të Kosovës, në periudhën e parandalimit të konfliktit, gjatë konfliktit dhe rolin e tyre në fazën emergjente të rindërtimit të Kosovës pas luftës por edhe në fazën e stabilizimit, pavarësimit dhe rrugës drejt integriteteve Euro-Atlantike.

Duke marr parasysh rëndësinë e organizatave ndërkombëtare dhe ndikimin global të tyre, përfshirja e tyre në ngjarjet e Kosovës ishte e pashmangshme. Në arenën ndërkombëtare, në mes të një numri shumë të madh të organizatave multilaterale, ekziston një rregull që u dëshmuar në Kosovë. Edhe pse jo secila organizatë e bëri të pamundurën që të kontribuojë në përmirësimin e gjendjes në Kosovë, gjatë fazave të ndryshme të problemit, është vërejtur një koordinim dhe bashkëpunim i mirëfilltë në mes tyre.

Ky punim në vijim do të elaborojë mbi qëndrimet, deklaratat, rezolutat dhe veprimet e bashkësisë ndërkombëtare të grupuar rreth organizatave multilaterale siç janë: Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB), Bashkimi Evropian (BE), Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), Aleanca Veri-Atlantike (NATO), Grupi i Kontaktit, Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), Banka Botërore (BB) dhe të tjera.

Që nga viti 1989 ngjarjet në Kosovë u gjenden në agjendat e takimeve të këtyre organizatave. Por jo gjithmonë këto organizata kishin qëndrime të qarta ndaj çështjes së shtruar. Ky punim do të tentojë të paraqesë qëndrimet dhe qasjet e organizatave të ndryshme në rrethana të ndryshme dhe mospajtimet në lidhje me kahjen e procesit dhe veprimet e organizatës në fjalë përballë problemit të shtruar.

Qëllimi i punimit është që të elaborojë mbi kompleksitetin e rrethanave politike në të cilin janë ushtruar mandatet e organizatave multilaterale në Kosovë dhe ndryshimi i qasjes së tyre në faza të ndryshme të ngjarjeve në Kosovë. Vështrim i posaçëm analitik do t'i kushtohet rolit të OKB-së dhe BE-së dhe qëndrimet e tyre karshi rrethanave politike dhe humanitare në Kosovë.

2. POZITA E KOSOVËS BRENDË FEDERATËS JUGOSLLAVE

Shqiptarët e Kosovës, megjithëse shumicë, gjithmonë kanë qenë të shtypur. Sipas udhëheqjes politike të Prishtinës, kjo ka qenë arsyeja kryesore që ka përcaktuar gjithë marrëdhëniet e Shqiptareve me Sërbinë. Të drejtat e shqiptarëve në ish-Jugosllavi kanë kaluar në periudha të ndryshme. Kjo gjendje është interpretuar në menyra të ndryshme nga te dy komunitete më të mëdha në Kosovë.

Avokati Azem Vllasi, ish funksionar i lartë në Jugosllavi thotë se një periudhë me e ndritshme për shqiptarët e Kosovës, fillon pas vitit 1966. "Pas rënies së Rankoviqit, Kosova shënon një zhvillim të vrullshëm, më pak të penguar se deri atëhere, dukshëm më të lirshëm, ajo periudhë fillon pas vitit 1966 dhe zgjat deri në vitin 1981"¹, shprehet zoti Vllasi. Politikani serb, Momcillo Trajkoviq, ish funksionar në Federatën Jugosllave, thotë se shqiptarët e Kosovës të pakënaqur që janë lënë jashtë kufijve të Shqipërisë, janë munduar që në Jugosllavinë Socialiste të realizojnë të drejtat e tyre nacionale. "Unë mendoj se shqiptarët kanë perfituar më shumë se sa për shembull serbet në Kosovë, të cilet pas vitit 1945 janë lënë anash. Gjithë politikën në Kosovë e kanë udhëhequr komunistët malazezë dhe shqiptar, ndersa serbet janë lënë jashtë lojës dhe këtu unë e shoh një problem të madh, i cili më pas ka marrë rrugën e tij"², thotë zoti Trajkoviq.

Nga fundi i viteve të 60-ta, shqiptarët filluan të bëhën më të zëshëm për të drejtat e tyre. Një grup studentësh dhe intelektualësh organizuan një demonstratë gjithëpopullore në vitin 1968. Zenun Qelaj ishte njëri nga gazetarët që ndoqi këtë demonstratë. "Lufta ishte për një barazi sikur të gjithë pjesëtarët tjerë të popujve që e përbenin Jugosllavinë. Policia që u soll nga pjesë tjera të Jugosllavisë u soll me shumë vrazhdësi ndaj demonstruesve, ndaj qytetarëve, u vendosen tanket para institucioneve kryesore, i ngjante vendosjes së një regjimi ushtarak që Kosova e kishte perjetuar praktikisht menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore", deklaroi zoti Qelaj.

¹ Buxhovi, Prof., Jusuf, "Kthesa historike – Lufta e perëndimit për Kosovën", Shtëpia botuese Faik Konica, Prishtinë, 2009, 89f

² Buxhovi, Prof., Jusuf, "Kthesa historike – Lufta e perëndimit për Kosovën", Shtëpia botuese Faik Konica, Prishtinë, 2009, 95f

2.1 PËRMIRËSIM STATUSI

Demonstratat e shqiptarëve në vitin 1968 çuan në përmirësimin e statusit të shqiptarëve në ish Jugosllavi. Në vitin 1969 gjuha shqipe u sanksionua me ligj si gjuhe e dytë zyrtare, pas asaj serbo-kroate; u legalizua përdorimi i flamurit kombëtar shqiptar, ndërsa në shkurt të vitit 1970 u themelua edhe Universiteti i Prishtinës. Në rrethana të vështira, pasuan aktivitetet e pareshtura politike të shqiptarëve për realizimin e të drejtave të tyre në ish Jugosllavi, të cilat filluan të perfillen me miratimin e Kushtetutes së vitit 1974.

Kjo kushtetut e ngriti Kosovën në entitet të fortë juridik në federatën jugosllave. Kosova fitoi të drejtën e përfaqësimit në të gjithë organet e administratës dhe të pushtetit ekzekutiv dhe kishte të drejtën e vetos në federatën e atëhershme jugosllave, sikurse gjashtë njesitë tjera federale. Iljaz Kurteshi njëri prej funksionarëve më të lartë të Federatës Jugosllave, në vitin 1974 ishte kryetar i Kuvendit të Kosovës dhe i Komisionit Kushtetues.

"Kosova ka pasur anëtarin e Kryesisë në kuader të sistemit ish-jugosllav, Kosova ka marrë pjesë në zgjidhjen e të gjitha çështjeve. Pa Kuvendin e Kosovës nuk ka mundur të aprovohet asnjë vendim që kishte me qenë i rëndësishëm për sistemin jugosllav në përgjithësi"³, u shpreh zoti Kurteshi.

2.2 DEMONSTRATAT E VITEVE '80 – SHKELJET E PARA TË TË DREJTAVE TË NJERIUT

Në pranverën e vitit 1981 në Prishtinë u zhvilluan protestat të fuqishme studentore. Shkak për këto ishin kushtet e vështira në Universitet. Vendimtar në përhapjen e pakënaqësisë së përgjithshme ishte fakti që studentet pas përfundimit të studimeve nuk kishin thuar asnjë perspektivë për të gjetur vende pune. Protestat kishin kryesisht karakter ekonomik dhe social. Mes studentëve protestues gjendeshin edhe ato grupe të cilat zgjidhjen për gjendjen e nderë sociale dhe ekonomike e shikonin në ngritjen e statusit të Kosovës në rang republike.

³ Buxhovi, Prof., Jusuf, "Kthesa historike – Lufta e përcaktimit për Kosovën", Shtëpia botuese Faik Konica, Prishtinë, 2009, 145f

Partia dhe udhëheqja shtetërore u zunë krejt në befasi dhe reaguan vetëm me anën e forcës. U bënë arrestime të panumërta dhe në krahinë u vendos gjendja e jashtëzakonshme. Shkollat dhe fabrikat u mbyllën, u vendos shtetrrëthimi dhe e gjithë krahina u izolua.

Shpërthimi i trazirave në Kosovë e tronditi sistemin politik të vendit dhe ia hapi rrugën procesit të shpërbërjes, i cili në vitin 1990 solli shkatërrimin e Jugosllavisë. Fakti që pikërisht krahina e Kosovës e cila i përkiste Serbisë, u bë vatra ku shpërthyen konfliktet sociale dhe nacionale qëndron në lidhje të ngushtë me konceptin mbarëjugosllav. Në mënyrë që drejtpeshimi i Federatës shumëkombëshe të mos prishej për shkak të interesave të veçanta nacionaliste, Tito⁴ kishte ndërtuar një sistem të zgjuar rotacioni, me anë të së cilit qeverisja u kalonte me radhë çdo vit tetë përfaqësuesve të republikave dhe krahinave. Me vdekjen e Titos më 1980 kjo strukturë e pushtetit filloj të rrënohet dalëngadalë, forcat qendërikëse filluan të fitonin epërsi ndaj forcave integruese.

Shtypja me dhunë e protestave dhe paaftësia e partisë përballë krizës ekonomike që po rritej vazhdimisht ndikuan së tepërmi në polarizimin e të dyja grupeve etnike në krahinë. Në Beograd dëgjoheshin gjithmonë e më fort ato zëra që thoshin se e paskëshin ditur që Shqiptarët ishin një faktor i paqëndrueshëm brenda federatës dhe se vetëm një Serbi e fortë mund t'i bënte ballë kësaj gjendjeje⁵.

Masat për luftimin e të ashtuquajturave “veprimtari revizioniste dhe irredentiste” u zbatuan mbi tërë popullsinë civile⁶. Forcat e sigurisë të vendosura në Kosovë u kujdesen që të mos kishte më protesta dhe manifestime. Policia edhe një herë internoi persona gjoja të dyshimtë dhe kreu biseda informative dhe arrestime të panumërta. Nga marsi 1981 deri në nëntor 1988, 584.373 kosovarë⁷, gati gjysma e popullsisë së rritur u preken nga këto masa.

⁴ Presidenti pervjetshem i ish-Jugosllavisë, krijuesi i idese te federalizmit dhe shtetit te Sllaveve ne Ballkan

⁵ Malcolm, Noel, “Kosovo: a short history”, Paperback, 1998, fq. 36

⁶ Pietrisch, Wolfgang, “Kosova dhe bashkësia nderkombetare”, Shtepia botuese Koha ditore, 2002, Prishtine, fq. 15

⁷ Nga raporti i organizates nderkombetare “Human Rights Watch” te publikuar ne vitin 1988

Si pasojë, marrëdhëniet ndëretnike pësuan një politizim të theksuar. Mosbesimi ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve erdhi duke u rritur dhe te të dyja grupet etnike filloi një proces i brendshëm konsolidimi⁸. Gjendja e përgjithshme e keqe nuk u shqyrtua dhe nuk u kërkua ndonjë strategji për një zgjidhje të përbashkët, por përgjegjësia iu hodh grupit tjetër etnik. Kjo solli së fundi dobësimin e lidhjeve shoqërore aspak të forta midis shqiptarëve dhe serbëve.

⁸ Misha Glenny "The Balkans – nationalism, the war and great powers" Granta books, 1999, 95f

3. SHPËRBËRJA E JUGOSLLAVISË

Përderisa republikat relativisht të zhvilluara të veriut, Sllovenia dhe Kroacia, kërkonin liberalizimin dhe decentralizimin e ekonomisë, republikat e jugut rrugëdaljen nga kriza e shikonin në forcimin e dirigjimit federal.

Kushtetuta e vitit 1974 e cila kërkonte të realizonte bashkëpunim ndërmjet republikave mbi bazën e të drejtave të barabarta kishte dhënë efektin e kundërt. Gjashtë republika dhe dy krahina autonome kishin krijuar një mëvetësi të gjerë duke krijuar qendrat e veta të pushtetit dhe zona ekonomike të veçuara. Në vitet '80 kur si rezultat i rënies ekonomike filloi lufta për ndarjen e resurseve që sa vinin e pakësoheshin, shpërthyen me forcë kontradiktat për ndërtimin dhe udhëheqjen e shtetit. Ndërsa Serbia ishte për ricalizimin e shtetit dhe ruajtjen e sistemit shoqëror socialist, Sllovenia dhe Kroacia kërkonin krijimin e një konfederate, ku republikat të kishin pavarësi të gjerë me struktura të forta pluraliste dhe të ekonomisë së tregut.

Në vijim Kosova u kthye në një temë kyçe të politikës Serbe, të tillë që nga zgjidhja e çështjes së Kosovës qenkësh varur fati i Serbisë brenda Jugosllavisë, së paku kështu mendonin forcat nacionaliste që po forcoheshin gjithnjë e më tepër në qarqet akademike, në media, në kishën ortodokse dhe udhëheqjen komuniste.

Edhe akademika e shkencave dhe e arteve e Serbisë shprehu pikëpamjet e saj mbi krizën me anë të projektit të një memorandumit⁹. Ky projekt u hartua nga një grup intelektualësh të njohur serbë, të udhëhequr nga shkrimtari Dobrica Qosiq. Shqiptarët u akuzuan se synonin të kryenin një gjenocid fizik, juridik dhe kulturor kundër popullit serb në Kosovë. Autorët mbronin pikëpamjen se “çështja serbe” mund të zgjidhej vetëm nëse do të arrihej t'i bëhej ballë rrezikut që vinte nga shqiptarët e Kosovës. Me këtë kuptohej kufizimi i menjëhershëm i autonomisë, pezullimi i lidhjeve me Shqipërinë dhe deshqiptarizimi i plotë i krahinës.

⁹ Projekti famëkeq për krijimin e Serbisë së Madhe i udhëhequr nga Akademia e shkencave dhe arteve e Serbisë

Politika e marginalizimit e ndjekur në periudhën mes dy luftërave si dhe vitet e Rankoviçit kishin bërë që shqiptarët t'iu ktheheshin institucioneve të tyre tradicionale të vetëqeverisjes¹⁰.

Në të njëjtën kohë në Beograd ishte krijuar një makinë tmerruese propagandiste në lidhje me shkaqet e largimit të popullsisë serbe nga Kosova.

Kategoritë e dëbimit ose gjenocidit që u përdoren nga propaganda serbe janë gjithsesi të tepruara dhe shërbyen para se gjithash për të krijuar një ndjenjë anti-shqiptare dhe për të polarizuar klimën politike. E njëjta gjë vlen edhe për përpjekjet e shumë mediave për t'i kriminalizuar sistematikisht shqiptarët. Kjo situatë e tensionuar vazhdoi për 10 vjet me radhë.

Në këtë periudhë të karakterizuar nga një atmosferë shoviniste, në pushtet u ngjiti Slobodan Millosheviç¹¹. Ai doli të gërshetonte mirë profilin e mbrojtësit të kombit serb me imazhin e reformatorit politik dhe ekonomik. Ngjarjet e Kosovës ishin një “kornizë” ideale për këtë.

Në prill të vitit 1987 ai u takua me serbët e Kosovës ku ata shprehen pakënaqësi të madhe në lidhje me jetën e tyre në Kosovë. Pas këtyre takimeve ai la të kuptohet se pa mëdyshje Kosova këtej e tutje do të ishte çështja e tij.

Në ndeshjen për Kosovën, Beogradi shfrytëzoi fuqimisht mitin e Kosovës, rëndësinë e saj kulturore dhe historike për identitetin serb. Në këtë rast duhej të zbatoheshin drejta “historike” e cila e vendoste Kosovën në qendër të identitetit serb dhe jo e drejta e vetëvendosjes së shumicës së popullsisë.

¹⁰ Stavileci, Prof., Esat, “Sistemi i delegatëve”, Rilindja, 1980, 77f

¹¹ Slobodan Millosheviç, Kryetar i Srbisë dhe udhëheqës dhe ideator i politikës pushtuese Serbe, në vitin 2000 i arrestuar nga Gjykata Nderkombetare e Hagës, ku edhe vdiq pa iu shqiptua dënimi

Këtë qëndrim e ka përcjellë edhe retorika e pushtetit të asaj kohe. Në një nga demonstratat në Beograd, Millosheviçi iu drejtua demonstruesve me këto fjalë “Çdo popull e ka një dashuri që ia ngroh zemrën përjetësisht. Për Serbinë kjo është Kosova”.

Me 23 mars 1989 nën tryninë dhe mbikëqyrjen e ushtrisë dhe policisë së fshehtë, Parlamenti krahinor miratoi amendamentet kushtetuese pas një votimi të trazuar. Me këtë hap autonomia e krahinës praktikisht u hoq.

Protestat dhe manifestimet e dhunshme që vijuan u shtypën brutalisht. Sipas Amnesty International rreth 140 vetë gjeten vdekjen¹², ndërsa qindra të tjerë u plagosën. Mijëra vetë u dënuan pas proceseve “rrufe” me 20-60 ditë heqje lirie. Hapi tjetër u drejtua kundër intelektualëve dhe personaliteteve udhëheqëse të ekonomisë dhe politikës, të cilët u arrestuan në shtëpitë e tyre ose në vendet e punës në orët e para të mëngjesit dhe u çuan menjëherë në burgje, ku u izoluan pa iu dhënë të drejtën e mbrojtjes.

Si përgjigje deputetët e mbledhur përpara godinës së Parlamentit e shpallën Kosovën Republikë; pra shpallën pavarësinë e Kosovës në kuadrin e Federatës Jugosllave.

Një nga hapat e parë të pushtetit të dhunshëm Serb ishte kalimi i kompetencave të sigurisë të krahinës në duart e Ministrisë së Brendshme të Serbisë. Hapi tjetër ishte vënia e mediave nën kontrollin serb. E njëjta gjë ndodhi me shtypin në gjuhën shqipe, i cili u pezullua tërësisht. Pasoja veçanërisht të rënda sollën masat e serbizimit në fushën e arsimit. Futja e detyruar e planit mësimor serb dhe ndalimi i librave shqiptare, të cilat arritën kulmin me bojkotimin e përgjithshëm e sistemit shkollor. Historia shqiptare u mënjanua pothuajse tërësisht duke u zëvendësuar me atë serbe dhe mësimi i gjuhës dhe i letërsisë shqipe u pakësua në minimum. Në dhjetor 1990 as nxënësit dhe as mësuesit shqiptarë nuk mund të hynin në objekte shkollore pa shprehur më parë pranimin e planit të rri arsimor serb. Pas kësaj shqiptarët filluan të bojkotojnë mësimin dhe të ngrenë shkolla private.

¹² Raporti i Amnesty International mbi Kosoven, 1989

Serbizimi vijoi në fushat e shëndetësisë, industrisë, tregtisë dhe zejtarisë. Parlamenti serb miratoi një ligj i cili vendoste kritere etnike për marrjen në punë në ndërmarrje dhe institucione publike.

Diskriminimi jozyrtar, institucional dhe ideologjik ndaj shqiptarëve u shoqërua që në fillim me masa të dhunshme ndaj popullsisë civile. Përveç njësive të policisë speciale serbe, të cilët kishin marrë nën kontroll krahinën, në Kosovë u aktivizuan edhe njësitë e dhunshme radikale paraushtarake.

Me 23 dhjetor 1989 u themelua Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) kryetar i së cilës u zgjodh kritiku letrar Ibrahim Rugova¹³. Shumë shpejt LDK-ja u shndërrua në lëvizjen e përgjithshme politike më të rëndësishme për popullsinë shqiptare. LDK-ja kishte pozicionin fillestar më të mirë ndër të gjithë partitë e tjera shqiptare. Në kohën e krijimit të pjesës më të madhe të partive të tjera, LDK-ja kishte një infrastrukturë funksionale dhe një numër të madh anëtarësh. Me pretendimin për të qenë një lëvizje politike gjithëpërfshirëse, ajo monopolizoi më pas udhëheqjen politike dhe e quajti veten si përfaqësuese të interesave të mbarë shqiptarëve të Kosovës. LDK-ja nuk tregoi shume interes për krijimin e një platforme të përgjithshme të partive demokratike¹⁴.

Ushtrimi i dhunës nga aparati shtetëror serb i shtyu shqiptarët e Kosovë të vetëpërbahen. Në këtë kontekst u paraqit fenomeni i “pacifizmit të imponuar” përballë një armiku i cili konsiderohej si tejet i prirur për dhunë dhe vazhdimisht kërkonte të shkaktonte përplasjen e dhunshme. Pacifizmi u bë në këtë mënyrë një opsion për të mbijetuar. Qëndresa pasive dhe kurajoja e lartë qytetare dhe shoqërore do t’i tregonin botës se padrejtësia nuk e kishte zanafillën prej tyre, por tek ata, të cilët i akuzonin parreshtur. Në këto rrethana shqiptaret zhvilluan një kulturë opozitare e cila e ktheu kontrastin në anën e kundërt duke u distancuar rrënjësisht nga akuzat e propagandës

¹³ Ibrahim Rugova, (1944-2006) simbol i rezistencës paqësore

¹⁴ Klark, Howard, “Civil Resistance in Kosovo”, Pluto Press, London, 2000, 177f

serbe. Një nismë sensacionale për forcimin e unitetit kombëtar ishte edhe fushata e pajtimit të gjaqeve, e filluar në vitin 1990¹⁵.

Baza e organizimit shoqëror pas heqjes së autonomisë dhe mënjanimit të shqiptarëve nga qeverisja ishte ndërtimi i strukturave paralele politike dhe shoqërore. Ngritja e institucioneve të veta ishte një dimension i ri i qëndresës. Shumë njerëz që nuk kishin zë në zhvillimet politike panë këtu një mundësi për t'u aktivizuar dhe për të shprehur solidaritetin e tyre. Qeveria Kosovare e cila më 1992 e kishte selinë e vet në Bon kishte edhe sistemin e raportimit financiar. Burimi i buxhetit të kësaj qeverie ishte tre përqindëshi i të ardhurave të emigrantëve kosovarë por edhe tatimet të cilat u mbledheshin brenda Kosovës të përcaktuara në bazë të ardhurave. “Më 1993 prej këtij fondi janë financuar rreth 20.000 mësues, ligjërues dhe profesorë për arsimimin e 317.000 nxënësve dhe 12.000 studentëve¹⁶”.

Ngritja e aparatit të pavarur arsimor u bë pasi Beogradi gradualisht e ndaloi mësimdhënien në gjuhën shqipe dhe e përshtati planin pedagogjik të Kosovës me qëllimet e veta nacional-pedagogjike. Në vitin 1991 arsimtarët shqiptarë u përjashtuan nga sistemi i pagave.

Popullsia nuk kishte besim as tek institucionet shëndetësore. Në raste të ngutshme nuk kishte rrugë tjetër përveç klinikave private të pajisura varfërisht, të ngritura nga mjekët e pushuar nga puna. Një rol të rëndësishëm e luajti shoqata “Nëna Terezë” e themeluar në Prishtinë në vitin 1992 që ofronte ilaçe dhe mjekime falas për të gjithë nevojtarët. Deri në vitin 1998 kjo organizatë krijoi një rrjet prej 91 klinikash në tërë vendin. “Nëna Terezë u mbështet nga organizatat ndërkombëtare Medecins Sans Frontieres dhe Catholic Relief Service¹⁷”.

¹⁵ Fushatë më masive e pajtimit e udhëhequr nga Anton Ceta e cila kontribuoi edhe në ngritjen e unifikimit dhe solidarizimit të popullit shqiptar

¹⁶ Pietrisch, Wolfgang, “Kosova dhe bashkësia nderkombetare”, Shtëpia botuese Koha ditore, Prishtinë, 2002, 139f

¹⁷ Medecins Sans Frontieres dhe Catholic Relief Service, organizata ndërkombëtare humanitare aktive në Kosovë nga viti 1992 deri pas luftës

Si arsimi dhe shëndetësia edhe mediat iu nënshtuan një serbizimi rrënjësor. Botimi i gazetave të përditshme më të rëndësishme u ndërpre dhe të dyja shtëpitë botuese kryesore shqiptare u përfshinë në ndërmarrjen serbe Panorama. Ngjashëm u zhvilluan ngjarjet edhe në sektorin e radios dhe televizionit. Sa i përket ekonomisë, baza e ekonomisë kosovare ishte ngritja e bizneseve të vogla dhe të mesme dhe puna në emigracion.

Në periudhën midis viteve 1989-1998 rreth 400.000 kosovarëve u larguan nga toka e tyre drejt Evropës Qëndrore dhe Perëndimore dhe shumica prej tyre për t'i shpëtuar thirrjes për të kryer shërbimin në ushtrinë jugosllave.

3.1 PAS SHPËRBËRJES SË JUGOSLLAVISË DHE PAS PËRFUNDIMIT TË LUFTËS NË BOSNJE

Në gusht 1992 në Londër, nën drejtimin e OKB-së u zhvillua një konferencë për Jugosllavinë, e organizuar nga vendi mikpritës, në të cilën përveç palëve ndërluftuese, morën pjesë edhe shumë përfaqësues të BE-së dhe OKB-së. Në të ishte ftuar edhe një delegacion i nivelit të lartë nga Kosova, por anëtarët e tij nuk u lejuan të merrnin pjesë drejtpërdrejt në Konferencë por vetëm të ndiqnin punimet e saj në televizor. Kosovarët i drejtuan një memorandum Konferencës ku kërkonin trajtimin e Kosovës në mënyrë të barabartë me njësitë e tjera konstitutive të Federatës Jugosllave. Në të theksohej se heqja e autonomisë ishte shkelje e kushtetutës, ndaj së cilës kosovarët kishin reaguar me vetëpërmbytje dhe në kuadër të ligjeve ekzistuese. Por sipas pikëpamjes së bashkësisë ndërkombëtare, SHBA-ve dhe BE-se, gjendja paraqitej ndryshe.

Dy krahinat autonome, Kosova dhe Vojvodina, nuk ishin njohur si pjesë sovraane të Federatës Jugosllave dhe për këtë arsye nuk u njohën si palë në çështjen e trashëgimisë së Jugosllavisë. Ky vendim bazohej në përfundimet e të ashtuquajturit Komisioni të Badinterit, i cili u krijua nga BE-ja në vitin 1991 për sqarimin e çështjes së trashëgimisë shtetërore të Jugosllavisë. Sipas kriterëve të këtij komisioni krahinave autonome në ndryshim nga republikat nuk iu njoh e drejta e shtetësisë. Argument tjetër i shqiptarëve të Kosovës ishte parimi i vetëvendosjes. Por e drejta e vetëvendosjes iu njoh vetëm entiteteve që kishin statusin e kombit. Megjithëse Kosova në bazë të Kushtetutës së vitit

1974 kishte një autonomi të gjerë, e cila i garantonte krahinës thujtse të gjitha drejtat e republikave, shqiptarët e Kosovës nuk mundën të fitonin as statusin e republikës dhe as njohjen e tyre si komb brenda Federatës.

Edhe fakti që Kosova i përmbushte të gjitha kushtet formale të nevojshme për krijimin e shtetit sipas kriterëve ndërkombëtare – ajo kishte territorin e vet, një popullsi e cila në shumicën e saj kërkonte pavarësinë, qeverinë e vet – nuk e bindi Komisionin e BE-së për legjitimitetin e kërkesës së kosovarëve¹⁸. Edhe fakti që autonomia u hoq me dhunë dhe se që atëherë në krahinë të drejtat e njeriut u shkelen në mënyrë drastike nuk u mor parasysh në vendimin e komisionit.

Shqiptarët e priten me zhgënjim të hidhur rolin që u ishte caktuar në Londër. Zhgënjyese ishin edhe përfundimet e bisedimeve jozyrtare për zgjidhjen e çështjeve të diskutueshme. Në deklaratën e kryesuesve të Konferencës, Serbisë i kërkohet që të rivendoste të drejtat qytetare dhe kushtetuese së popullsisë së Kosovës. Veç kësaj kërkesë të vakët, u formua një Grup i Posaçëm për Kosovën (Kosovo Special Group) i cili kishte për detyrë të ftonte të dyja palët për të marrë qëndrim për çështjen e statusit dhe në vijim t'ia hapte udhën procesit të bisedimeve mbi këtë çështje. Në Konferencën e Londrës u bë i qartë qëndrimi i bashkësisë ndërkombëtare për çështjen e Kosovës, qëndrim i cili në vitet në vijim praktikisht do të mbetet i pandryshuar. Me shpërthimin e luftës në Kroaci dhe në Bosnje, Kosova mbeti në plan të dytë. Deri në shpërthimin e dhunës në Kosovë, për bashkësinë ndërkombëtare mjaftonte që me gjysmë zemre të kërkojë nga Beogradi të riktheje autonominë e krahinës në kuadër të Serbisë. Ky qëllim duhet të arrihet vetëm me dialog dhe me marrjen e masave për krijimin e besimit. Në vijim ky fjalor do të gjendet në deklaratatë të shumë politikanëve perëndimorë.

Marrëveshja e paqes e Dejtonit¹⁹ u solli Kosovarëve edhe një tjetër zhgënjim të hidhur. Që në fillim ishte bërë e qartë se shpresat e bashkësisë ndërkombëtare për paqen në ish-

¹⁸ Pettifer, James, "The Albanian Question – Reshaping the Balkans", I.B. Taurus & Co Ltd, New York, 2006, 59f

¹⁹ Marrëveshja e Dejtonit, marrëveshje paqe trepalëshe e cila shënon mbarimin e luftës së përgjakshme në Bosnje dhe Hercegovinë

Jugosllavi nuk i linin shumë vend kërkesës së kosovarëve për pavarësi. Në bisedime nuk u ftua asnjë përfaqësues i Qeverisë së Kosovës dhe u injorua tërësisht fakti që çështja e Kosovës kishte nevojë për një zgjidhje të ngutshme.

Pas lëshimeve që iu ishin bërë sllovenëve dhe kroatëve nuk dëshirohej të fitohet përshtypja se shtytja e pavarësimit bëhet në baza etnike dhe nacionale. Për zgjedhjen e kësaj çështje bashkësia ndërkombëtare kishte nevojë për pëlqimin e Millosheviçit, i cili, duke mbështetur variantin e Bosnjës së bashkuar faktikisht, mundi të fitonte diëka edhe në çështjen e Kosovës. Nëse Serbet e Bosnjës kishin fituar shtetin e tyre, në çështjen e Kosovës Miloshviqi do të gjendej përballë një trysnie të fortë ndërkombëtare.

Shqyrtimi i parimeve dhe qëllimeve të aktorëve të veçantë të bashkësisë ndërkombëtare na lejon të kuptojmë se kjo bashkësi në të vërtetë ishte një grup tepër heterogjen²⁰. Ky përcaktim ka të bëjë kryesisht me aktorët evropianë dhe u shpreh në vlerësime të gabuara dhe në ndryshime të vazhdueshme të kursit që karakterizuan politikat e shteteve evropiane ndaj Jugosllavisë. Ndërsa SHBA-ja e kishte të lehtë të fliste me një zë, evropianët kishin një kor polifonik i vështirë për t'u akorduar që të këndonte në harmoni. “Evropianët” të zënë krejtësisht të befasuar nga shpërthimi i luftës dhe pa përvojë për menaxhim kolektiv të krizës, për një kohë të gjatë nuk mund të gjenin asnjë rrugëdalje përballë forcave luftënxitëse në Jugosllavi²¹.

Një arsye tjetër vendimtare që e shtyu çështjen e Kosovës në plan të dyte ishte dhe mbingarkesa që solli lufta në Jugosllavi në politikën e jashtme rudimentare evropiane. Vëmendja kryesore u përqendrua në arritjen e zgjidhjeve paqësore për konfliktin serbo-kroato-boshnjak. Futja edhe e çështjes së Kosovës në zgjidhjen e përgjithshme paqësore për Jugosllavinë do të bënte që Beogradi të mos ishte i gatshëm për kompromise me Kroacinë dhe në çështjen e Bosnjës.

²⁰ Clark, Howard, “Civil resistance in Kosovo”, Pluto Press, London, 2000, 189f

²¹ Clark, Howard, “Civil resistance in Kosovo”, Pluto Press, London, 2000, 230f

Me lënien jashtë vëmendjes të Kosovës u la jashtë një faktor i rrezikshmërisë i cili me kompleksitetin e vet do të vinte në rrezik të gjithë rregullimin paqësor si edhe baraspeshën e brishtë të fuqive të mëdha.

Nga këndvështrimi i shqiptarëve të Kosovës u bë e qartë se politika e tyre e mosbindjes qytetare dhe e mospërdorimit të dhunës kishte dështuar.

3.2 PERIUDHA 1997-1998

Gjatë kësaj periudhe diplomacia multilaterale bëri një hap përpara që nga çështja e të drejtave të njeriut tek autonomia substanciale.

LDK-ja kishte monopolizuar të gjithë përfaqësimin politik të shqiptarëve të Kosovës dhe gjendej nën një trysni të fortë dhe të shumëanëshme. Pikëpamja se një zgjidhje brendajugosllave për Kosovën mund të përkrahet më me forcë prej bashkësisë ndërkombëtare filloi të dëgjohet gjithnjë e më shpesh. Një propozim të tillë e bëri Adem Demaçi më 1996, ish kryetar i këshillit për mbrojtje të lirive dhe të drejtave të njeriut si dhe botues i së përjavshmes Zëri. Ai në vitin 1996 u hodh në politikë dhe u zgjodh kryetar i partisë parlamentare të Kosovës. Ndryshe nga Rugova, Demaçi mund të parafytyronte edhe një status më të ulët se pavarësia, por për të ai kërkoi një veprim më konkret dhe më të vendosur.

Ky polarizim politik u përqua menjëherë tek popullsia kosovare dhe nxori në skenë ato forca të cilat prej kohësh kërkonin të ndryshonin gjendjen me anë të dhunës.

Në shkurt të vitit 1996 ndodhën disa sulme me bomba kundër aparatit policor të Serbisë. Përgjegjësinë për këtë e mori Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK). Gjatë vitit 1996 UÇK-ja filloi të botonte edhe buletin për aktivitete dhe komente të saj në lidhje me ngjarje të politikës ditore. Me 28 nëntor 1997 tre luftëtarë të maskuar të UÇK-së u shfaqën për herë të parë botërisht në varrimin e një mësuesi të vrarë nga njësitet serbe, për të shpallur së UÇK-ja ishte e vetmja forcë që luftonte për “çlirimin dhe bashkimin

kombëtar të Kosovës”. Vetëm disa ditë më pas UÇK-a mori përgjegjësinë për një sërë sulmesh. “Në shënjestër të saj ishin edhe “kolaboracionistët” dhe “tradhtarët”, njerëz që ishin rreshtuar në anën e armikut²²”.

Shfaqja e UÇK-së dhe frika për një shkallëzim të dhunshëm thirren së fundi në skenë bashkësinë ndërkombëtare, e cila u gjend e detyruar për të vepruar me vendosmëri. Ajo që nuk mundi të arrihej për vite të tëra me protesta paqësore dhe mosbindje qytetare, u arrit brenda pak muajve me anë të dhunës. “Megjithëse OSBE-ja kishte lajmëruar që më 1992-1993 për rrezikun e një katastrofe humanitare në Kosovë, bashkësia ndërkombëtare kishte nguruar të ndërhynte”.

Deri me 1997 bashkësia ndërkombëtare u mjaftua me kërkesat për të hequr dorë nga dhuna dhe për të treguar gatishmëri për dialog. Përcaktimi i statusit të Kosovës, për të cilin mund të pranohej një shkallë e lartë autonomie brenda kufijve të njohur në rrafshin ndërkombëtar, por jo shkëputja e Kosovës si shtet i pavarur, duhej të arrihet pa bisedimeve të drejtpërdrejta të palëve në konflikt. Pala kosovare nuk e pranoi këtë sepse kjo nënkuptonte bisedime mbi çështjet kushtetuese në kuadrin shtetëror jugosllav duke e njohur sovranitetin e Serbisë mbi Kosovën.

Një hap për shtendosjen e gjendjes do të hidhej me hapjen e zyrës së BE-së në Prishtinë dhe paralelisht me këtë në Bruksel do të akreditohej një ambasador i RSFJ-së pranë BE-së. Edhe një hap tjetër ishte rikthimi i misioneve vëzhguese të OSBE-së në Kosovë, pas dëbimit e tyre nga Beogradi në vitin 1993, pas pezullimit të Jugosllavisë nga OSBE-ja për shkeljet të rënda të primeve të organizatës.

Me intensifikimin e dhunës në Kosovë, bashkësia ndërkombëtare rriti trysninë mbi Beogradin dhe UÇK-në. Një ide në këtë drejtim ishte edhe përcaktimi i ndërmjetësuesve ndërkombëtarë të pranuar nga të dy palët për të mbështetur fillimin e dialogut. “Këtë

²² Pietrisch, Wolfgang, “Kosova dhe bashkësia ndërkombëtare”, Shtëpia botuese Koha ditore, 2002, Prishtinë, fq. 325

mendim e mbështeti edhe Kofi Annan²³ i cili vendosi të emëronte një person të veçantë për t'u marrë vetëm me këtë çështje". Të njëjtën gjë bëri edhe administrata shtetërore e SHBA-ve dhe në këtë detyrë emëroi Ambasadorin Gelbard.

I dërguari i SHBA-ve pas një takimi me Millosheviçin në Beograd edhe një herë pohoi qëndrimet e Uashingtonit zyrtar se parimet themelore të politikës amerikane ndaj këtij problemi bazohen në mosnjohjen e ndryshimeve të njëanshme të kufijve të njohura në arenën ndërkombëtare.

Me 28 shkurt Millosheviçi urdhëroi sulmin e parë masiv të policisë speciale serbe kundër qendrave të UÇK-së. Për Millosheviçin sinjali i Gelbardit ishte dritë e gjelbër për zgjidhjen ushtarake të problemit. Në sulmet e policisë serbe shumica e viktimave ishin pleq, gra dhe fëmijë. Vetëm disa ditë më pas më 5 mars, policia speciale serbe sulmoi fshatrat Prekaz i Ulët dhe Llaushë. Në këto sulme u vranë 58 shqiptarë, shumica e të cilëve gra, fëmijë dhe pleq. Ndërmjet viktimave të kësaj masakre ishte edhe Adem Jashari, i njohur edhe si një nga themeluesit të UÇK-së dhe që gëzonte respekt të madh si figurë simbolike e qëndresës së re të armatosur²⁴.

Të gjitha këto ngjarje e rritën tryshinë mbi bashkësinë ndërkombëtare. Për t'i dalë përballë shkallëzimit të dhunës u kërkuar të merreshin masa që të kapërcenin shkallën deklarative dhe të ishin të frytshme në praktikë²⁵. Parakusht për këtë ishte edhe bashkërendimi i nismave të ndryshme ndërkombëtare dhe para së gjithash, përputhja e politikës së SHBA-ve me atë të BE-së dhe Ruisë. "I ashtuquajturi Grupi i Kontaktit²⁶ i krijuar me 1994 gjatë luftës në Bosnje ishte një instrument i përshtatshëm për këtë qëllim".

²³ Sekretari i përgjithshëm i Kombëve të Bashkuara

²⁴ Clark, Howard, "Civil resistance in Kosovo", Pluto Press, London, 2000, 230f

²⁵ Pettifer, James, "Kosovo Express", C. Hurst and Co Ltd, London, 2005, 78f

²⁶ Mekanizëm jo formal i bashkësisë ndërkombëtare i krijuar për të koordinuar qëndrimin e bashkësisë ndërkombëtare ndaj zhvillimeve në Ballkan

Në një deklaratë të Grupit të Kontaktit të publikuar me 9 mars 1998 i kërkohej qeverisë serbe të tërhiqte brenda dhjetë ditësh njësitë e policisë speciale nga Kosova, të lejonte praninë e organizatave ndërkombëtare në Kosovë dhe të fillonte dialogun me përfaqësuesit politik të shqiptarëve. Përveç këtyre Grupi i Kontaktit shprehu mbështetje për misionin e OSBE-së në Kosovë. Për t'i shtyrë serbët drejt dialogut u vendos edhe embargoja për armatimet dhe një moratorium mbi eksportimin e kredive shtetërore dhe financimeve qeveritare dhe ndalimi i dhënies së vizave për përfaqësues të lartë të qeverisë serbe.

Prapë brenda Grupit të Kontaktit nuk kishte një qëndrim për forcën e deklaratës. Ndërsa SHBA-ja dhe Britania e Madhe votuan për një veprim të fortë dhe të vendosur, përfaqësuesit të Francës, Italisë dhe Ruisë më tepër anonin kundër kësaj ideje.

Kompromisi u arrit në këto çështje: Beogradit iu kërkuar të lejonte ekspertët ndërkombëtarë të mjekësisë ligjore të vërtetojnë akuzat për vrasje të civilëve shqiptarë dhe OKB-se iu kërkuar të dërgonte një komisioner të lartë për të drejtat e njeriut. Gjithashtu u kërkuar rikthimi i misioneve afatgjata të OSBE-së si dhe ngritja dhe organizimi ndërkombëtar, duke përfshirë edhe OJQ-të, për të mbështetur ndërtimin e strukturave civile dhe masat e ndihmës humanitare.

Grupi i Kontaktit u takua përsëri në Bon. As këtë herë anëtarët e Grupit të Kontaktit nuk ishin në një mendje sa i përket veprimeve të mëtejshme. Përsëri, përfaqësuesit e Francës, Italisë dhe Ruisë kishin vënë re përparimet dhe insistuan në një qasje më të butë, ndërsa SHBA-ja dhe Britania e Madhe kërkonin ashpërsimin e sanksioneve. Afati për përmbushjen e kërkesave të shtruar me 9 mars u shty edhe për katër javë. U ra dakord vetëm për të vendosur embargon e armëve ndaj Jugosllavisë, përfshirë edhe Kosovën. Pa dashur të paragjykonte përfundimet, rezoluta theksonte pikëpamjen e Grupit të Kontaktit sipas së cilës zgjidhja e çështjes së Kosovës mund të arrihej vetëm në kuadër të tërësisë territoriale të Republikës federative të Jugosllavisë në përputhje me standaret të OSBE-së dhe OKB-së. Së fundi, në rezolutë theksohej se “në rast se përpjekjet për paqe nuk arrinin

një përparim konstruktiv, do të merreshin ë shqyrtim masa tjera”. Rezoluta 1160²⁷ u miratua më 31 mars në Nju Jork.

Grupi i Kontaktit në të kohë ishte mekanizëm më efikas i bashkësisë ndërkombëtare në trajtimin e problemit dhe krizës në Kosovë. Edhe pas shumë përpjekjeve për të stabilizuar vendin, dhuna në Kosovë nuk u ndalua. Megjithatë Grupi i Kontaktit vazhdoi me misionin e vet dhe me 29 prill në Romë Grupi i Kontaktit u takua përsëri për të lëshuar një deklaratë dhe thirrje palëve në konflikt që urgjentisht të marrin masa për stabilizim të gjendjes së vendit. Në përputhje me Rezolutën 1160 Beogradit iu është kërkuar që menjëherë të ndërpriste të gjitha veprime luftarake. Njëkohësisht edhe udhëheqjes politike të kosovarëve iu është urdhëruar që të denoncojnë ashpër veprimet të dhunshme të UÇK-së. Pasi që Beogradi nuk pranoi të tërhiqte ushtrinë dhe policinë nga Kosova, Grupi i Kontaktit vendosi ngrirjen e fondeve të Jugosllavisë që ndodheshin jashtë vendit.

Gjatë kësaj periudhe pati përpjekje të numërta për të ndaluar dhunën. Këto përpjekje udhëhiqeshin nga Grupi i Kontaktit më angazhim më të madh të SHBA-së. Me iniciativën e Richard Holbrukut, emëruar nga qeveria e SHBA-së për të udhëhequr përpjekje për paqen, është organizuar edhe takimi në mes Millosheviçit dhe Rugovës. Edhe pse nën trynë të fort të opozitës në vend Rugova iu përgjigj kësaj ftese por pas një raundi bisedimesh, këto përpjekje nuk treguan shumë sukses.

Konsolidimi i ngadalshëm i diplomacisë ndërkombëtare nuk mundi të ndiqte ritmin e zhvillimeve ushtarake²⁸. Në qershor të vitit 1998 Komiteti ndërkombëtar i Kryqit të Kuq (ICRC) njoftoj se mijëra gra, fëmijë dhe pleq ishin dëbuar. Ata nuk mund të ktheheshin më në brendësi të Kosovës, kështu që shumë syresh u drejtuan në Shqipëri. ICRC-ja njoftoj se brenda Kosovës kishte mijëra refugjat, drejt Shqipërisë ishin drejtuar 10.000, dhe drejt Malit të Zi 3.000. Rreth 20.000 vetë ishin prekur drejtpërdrejt nga luftimet.

²⁷ <http://www.un.org/peace/kosovo/98sc1160.htm>

²⁸ Buxhovi, Prof., Jusuf, “Kthesa historike – Lufta e perëndimit për Kosovën”, Shtëpia botuese Faik Konica, 2009, 101f

Si kundërpërgjigje ndaj acarimit të gjendjes në Kosovë, Këshilli i NATO-së pas takimit të 28 majit në Luksemburg bëri të ditur se po hartoheshin plane për vendosjen paraprake të ushtarëve të saj në kufirin Shqipëri-Kosovë dhe në mes të gushtit do të kryhej një stërvitje e përbashkët me ushtrinë shqiptare. U bë e ditur se në shtator do të zhvillohej një manovër ushtarake në Maqedoni në kuadrin e marrëveshjes “partneriteti për paqe”. Sekretar i përgjithshëm i NATO’s, Solana, bëri të ditur disa ditë më pas se pas lajmeve shqetësuese “nuk përjashtohet asnjë mundësi” dhe se NATO-ja po përgatitet për “opsione mëtejshme ushtarake”. Në qëndrimin e Solanës, bëhej e qartë se NATO-ja nën drejtimin e SHBA-së synonte të vepronte me vendosmëri për të parandaluar përsëritjen e dramës së Bosnjës²⁹.

Sulmet kundër civilëve dhe spastrimet etnike, që kishin qenë tipike për luftën në Bosnjë, në asnjë mënyrë nuk duhej të përsëriteshin në Kosovë. Solana e përforcoi këtë qëndrim me fjalët: “Nëse bota ka mësuar diçka nga ky kapitull i errët i historisë, kjo është se ky lloj agresioni duhet përballuar menjëherë dhe me vendosmëri”. “Edhe pse Moska ishte kundër pranisë ose ndonjë veprimi eventual të “aleancës mbrojtëse perëndimore” nuk mundi të ofrojë asnjë strategji alternative³⁰”.

Reagimi i bashkësisë ndërkombëtare ndaj shkallëzimit të fundit ushtarak mbeti i ndryshueshëm. SHBA-ja dhe Britania e Madhe e cila ishte kryesuesja e radhës të Bashkimit Evropian, kërkonin një veprim më të ashpër ndaj Beogradit dhe shprehën zhgënjim ndaj Millosheviçit i cili vetëm pak përpara kësaj është takuar me Rugovën. Ato u përpoqën fort të shtinin në punë instrumentet thjesht perëndimore si BE-në dhe NATO-në për arsye se brenda Grupit të Kontaktit pritej që Rusia të mos pranonte vendosjen e sanksioneve të tjera.

Më 9 qershor BE-ja vendosi ndalimin e investimeve në Serbi dhe me 15 qershor në Shqipëri dhe në Maqedoni nisi manovra “Skifteri i vendosur”, në të cilën morën pjesë 83

²⁹ Pietrisch, Wolfgang, “Kosova dhe bahkësia ndërkombëtare”, Shtëpia botuese, Koha ditore 2002, Prishtinë, fq. 248

³⁰ Pietrisch, Wolfgang, “Kosova dhe bahkësia ndërkombëtare”, Shtëpia botuese, Koha ditore 2002, Prishtinë, fq. 250

avionë luftarakë nga 15 vende të NATO-s. Këto masa duhej të ishin paralajmërim i vendosur për Beogradin.

Në kundërpërgjigje të manovrave të NATO-s ushtria jugosllave përforcoi praninë e saj në kufirin me Shqipërinë. Përveç kësaj, Millosheviçi menjëherë bëri një vizitë zyrtare në Moskë. Bisedimet me Presidentin Jelcin u mbyllën me një marrëveshje xhentëllmenësh, me të cilën për herë të parë Millosheviçi lejoi praninë e vëzhguesve ndërkombëtarë në Kosovë dhe shpalli gatishmërinë e tij për akreditimin të një misioni të OSBE-se.

Më 6 korrik në bazë të marrëveshjes Jelcin-Millosheviç filloi ngritja e Misionit Diplomatik Vëzhgues për Kosovën (KDOM). Ky mision vepronte nën udhëheqjen politike të ambasadorëve të Grupit të Kontaktit, të ambasadorit austriak në Beograd si dhe përfaqësues i Kryesisë së BE-së dhe të Ambasadorit të Polonisë, e cila kishte kryesinë e radhës të OSBE-së. Qëllimi i këtij misioni ishte vëzhgimi i vazhdueshme dhe dokumentimi i ngjarjeve në Kosovë. Në Kosovë u vendosën civilë dhe të paarmatosur nga vendet e BE-së, SHBA-ja dhe Rusia. Midis korrikut dhe tetorit të vitit 1998 në Prishtinë dhe në pesë qytete të tjera të Kosovës vepronin më së 130 vëzhgues, shumica prej tyre nga vendet e BE-së dhe SHBA-ja.

Me gjithë ekzistencën e tij të shkurtër, me 13 tetor ky mision u shndërrua në Misionin Verifikues të Kosovës (KVM). Misioni ndërkombëtar vëzhgues ndikoi në mënyrë vendimtare në zhvillimin e mëtejshëm të angazhimit ndërkombëtar dhe hodhi bazat për hartimin e shpejtë të rezolutave të Këshillit të Sigurimit të Shtatorit dhe tetorit 1998.

Më 23 shtator Këshilli i Sigurimit i OKB-së e miratoi një Rezolutë të re (Rezoluta 1199)³¹ e cila mbështetej mbi njoftimet e KDOM-it, të organizatave humanitare, mbi vendimet e Grupit të Kontaktit dhe Marrëveshjen Jelcin-Millosheviç. Në të shprehje shqetësim i madh për shpeshimin e luftimeve dhe “përdorimin e tepruar dhe të verbër të dhunës nga ana e forcave Serbe të sigurisë dhe ushtrisë jugosllave”. Në bazë të kapitullit

³¹ <http://www.un.org/peace/kosovo/98sc1199.htm>

VII të kartës së OKB-së³², keqësimi i gjendjes në Kosovë u cilësua si “rrezik për paqën dhe sigurinë në rajon”. Në vijim Këshilli i Sigurimit vendosi që “në qoftë se masat e parashikuara në këtë rezolutë dhe në rezolutën 1160 (1998) nuk do të viheshin në jetë, do të shqyrtoheshin masa për veprime të tjera për arritjen ose sigurimin e paqes dhe ruajtjen e stabilitetit në këtë rajon”.

Vetëm një ditë pas kësaj Rezolute NATO-ja bëri të njohur të ashtuquajturin “activation éarning” (ACTWARN) i cili përfshinte mundësinë e një veprimi të kufizuar të aviacionit luftarak kundër Jugosllavisë. Sekretari i përgjithshëm i NATO-s Javier Solana, e përcaktoj vendimin e Këshillit të NATO-s si një sinjal të rëndësishëm politik për gatishmërinë e NATO-së për të përdorur forcën, nëse një gjë e tillë bëhet e nevojshme.

Sië pritej Rusia i hodhi poshtë planet për ndërhyrjen e NATO-s. Por përsëri u bë e qartë se Beogradi ishte i ndjeshëm ndaj trysnisë ruse. SHBA-ja dhe BE-ja bënë përpjeke të mëdha që ta shtynin Moskën për të lëvizur në këtë drejtim.

Në mbyllje të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së më 22. shtator, ministrat e jashtëm të BE-së vendosen të emërojnë ambasadorin austriak në Beograd, si të dërguar të posaçëm të BE-së për Kosovën.

Gjendja humanitare në Kosovë kishte nevojë për një ndërhyrje të ngutshme dhe se, si rrjedhojë e paaftësisë së Këshillit të Sigurimit për të vepruar, nuk kishte asnjë rrugëdalje, gjë që përlligjte një përjashtim nga rregulli i përgjithshëm. Për këtë arsye në aeroportin Heathrow të Londrës u zhvillua një takim i ministrave të shteteve anëtare të BE-së, SHBA-ve dhe Ruisisë. Ndërsa përfaqësuesit amerikanë votuan haptazi për anashkalimin e Këshillit të Sigurimit, evropianët u treguan skeptik dhe të përmbajtur. Rusia bëri të ditur se do të bllokonte me drejtën e vetos përdorimin e forcës kundër Serbisë. Në këtë mënyrë mbetej që NATO-ja të vazhdonte e vetme në këtë rrugë, gjë që, sipas Ministrit Rus, do të

³² <http://www.un.org/en/documents/charter/index.shtml>

sillte deklarata dhe sulme gojore shume të ashpra të Moskës kundër perëndimit, por pa ndonjë destabilizim të përgjithshëm serioz.

“Vendosmëria e Perëndimit për të përdorur forcën ushtarake në rast nevojë u shpreh pa mëdyshje më kthimin e ACTWARN-it në urdhër aktivizimi (ACORD)³³”. Urëdhri i aktivizimit parashikonte sulme ajrore të shkallëzuara në faza të ndryshme, në rast se Beogradi nuk ndryshonte qëndrim brenda 96 orëve.

Pas bisedimeve këmbëngulëse që zgjaten nëntë ditë më 13 tetor, në Beograd u nënshkrua e ashtuquajtura marrëveshje Hollbruk-Milloshëviç. Përfundimi i bisedimeve dhe marrëveshja mund të përmbliidhen në këto fusha:

- Pranimi i Millosheviçit të pakësonte numrin e njërive policore dhe ushtarake në nivelin e paraluftës
- Marrëveshja mbi vendosjen e 2.000 vëzhguesve të paarmatosur të OSBE-së dhe për fluturime mbikëqyrëse të avionëve pa municion të NATO-s.
- Hapja e hapësirës ajrore të RFJ-së për NATO-n.
- Katalog prej 11 parimesh të arritura ndërmjet SHBA-ve dhe Serbisë për zgjidhjen politike dhe planin kohor për vënien në jetë të saj.

Pjesët e përfunduara të Marrëveshjes u nënshkruan nga OSBE-ja, NATO-ja dhe pala serbe. Si rezultat i marrëveshjes është nënshkruar marrëveshja për mbikëqyrjen e hapësirës ajrore kosovare nga ana e NATO-s, në mes të NATO-s dhe Ushtrisë Popullore Jugosllave.

Si shtytje për zbatim të kësaj marrëveshje, Këshilli i Sigurimit të OKB-së miratoi edhe një Rezolute (Rezoluta 1203). Këshilli shperhu zyrtarisht përkrahjen për marrëveshjen e arritura dhe kërkoi zbatimin e plotë dhe të menjëhershëm të tyre nga ana e Republikës Federative të Jugosllavisë. Në rezolutë këmbëngulej si dhe më parë që gjendja në Kosovë përbente një kërcënim për paqen dhe stabilitetin në rajon.

³³ <http://www.nato.int/docu/pr/1998/p980924e.htm>

4. VITI 1999

Armëpushimi i arritur me 13 tetor solli një qetësim fillestar të gjendjes, në Kosovë kishte ende 200.000 persona të larguar nga shtëpitë e tyre. 42.000 vetë ishin larguar drejt Malit të Zi, rreth 20.000 drejt Shqipërisë dhe po aq drejt pjesëve të tjera të Serbisë. “Sipas UNHCR-it³⁴ një javë pas nënshkrimit të marrëveshjes, 50.000 vetë u kthyen në fshatrat e tyre”. Tërheqja e policisë speciale Serbe në kazerma jashtë Kosovës menjëherë pas miratimit të Rezolutës 1203 solli një përmirësim të gjendjes. Edhe ata 10.000 vetë që kishin ikur në male, ku gjenin përkujdesje kur mundnin, dhe e kalonin natën nën qiell të hapur ose nën mbulesa plasmasi.

Që nga shpërthimi i luftimeve shumë familje i kishin braktisur shume herë shtëpitë e tyre për t’u kthyer përsëri pas qetësimit të gjendjes. Por ne përgjithësi mund të thuhet me siguri se gjendja dramatike humanitare e fillimit të tetorit u zbut dukshëm.

Por pika më e dobët e marrëveshjes ishte përjashtimi prej saj i palës shqiptare. Problemi ishte se nga njëra anë Hollbruku kishte biseduar vetëm me Beogradin dhe në këtë mënyrë pala shqiptare nuk u tërhoq në hartimin e marrëveshjes. Nga ana tjetër, nuk do kishte qenë e mjaftueshme të bisedohej vetëm me Rugovën. Megjithëse Rugova, nën patronazhin amerikan, kishte bërë të njohur më 13. gusht grupin bisedues, ky kishte legjitimitet të kufizuar, sepse nuk përfshinte kampin e opozitës të afërt më UÇK-në³⁵. UÇK-ja ishte bërë një faktor i vështirë për tu llogaritur dhe që nga emërimi i Demacit si zëdhënës kishte filluar të binte në sy gjithnjë e më tepër. Por partner në bisedime për ndërmjetësimin ndërkombëtar vazhdonte të ishte vetëm LDK-ja dhe fraksionet e afërta me të.

Për të marrë sa më shpejt mbështetjen e kësaj palë për marrëveshje Hollbruk-Milloshëviç, i dërguari i posaçëm i BE-së, Petric, me 14 tetor, mbërriti menjëherë në Prishtinë, për të biseduar me Rugovën lidhur me mbështetjen e marrëveshjes. Sic pritej, reagimet e udhëheqjes shqiptare për këtë marrëveshje së pari ishin tejet të rezervuara deri në

³⁴ <http://www.unhcr.org/3e2d4d5f7.html>

³⁵ H. Peritt, Henry, Jr, “The history of an insurgency”, Chicago Kent College, Chicago, 2008, 79f

kundërshtuese. Për arsye të përvojave traumatizuese që kishin shqiptarët nga vendimet politik të hartuara dhe të vulosura nga të huajt, reagimi në Prishtinë ishte skeptik dhe i distancuar. Shqiptaret i ndjejnë të mënjeluar dhe të shpërfillur. Përveç kësaj, marrëveshja ishte hartuar në “mënyrën e të shkruarit të Beogradit”³⁶ dhe vetë versioni anglisht kishte shume terma administrative serbe. Megjithatë, bisedimet sollën një miratim të kujdesshëm të palës kosovare për misionin verifikues të OSBE-së dhe për mbikëqyrjen ajrore të NATO-s, të cilat Rugova i vlerësoi si “hapa pozitiv përpara”. I shoqëruar nga Ambasadori Gjerman dhe ai Britanik në Beograd, Petrici u takua edhe një herë, me 21 tetor, me Rugovën.

Ndërmjetësit ndërkombëtarë ngulën këmbë që Rugova tu drejtonte një thirrje grupeve të armatosura. Rugova e pranoi këtë kërkesë dhe me një deklaratë publike u bëri thirrje të gjitha grupeve të armatosura të shqiptarëve të Kosovës që të tregonin vetëpërmbytje për të mos u dhënë shkas për sulme të reja forcave të sigurisë³⁷. Në këtë deklaratë ai shprehu edhe përkrahjen për marrëveshjen Hollbruk-Milloshëviç dhe u bëri thirrje shqiptarëve të Kosovës që edhe ata të përkrahin. Por UÇK-ja nuk ndjehej aspak e detyruar ndaj deklaratës Rugovës. Përkundrazi ajo theksoj që do të ndiqte vetëm udhëzimet e udhëheqjes së vet politike, e cila në të vërtetë duhej të kundrohej si partnere në bisedimet. UÇK-ja bëri të ditur se gatishmëria e saj për armëpushim do të varej nga një shtojcë në marrëveshje, e cila duhej të parashikonte tërheqjen e plotë të forcave të sigurisë serbe dhe jugosllave dhe zëvendësim e tyre nga një polici kosovare, sipas përpjesëtimit etnik. Njëkohësisht luftëtarët e lëvizjes së thyer guerile shfrytëzuan menjëherë tërheqjen e njësive serbe për tu riorganizuar.

“Në këtë mënyrë u vërtetua edhe se një KVM i paarmatosur dhe mbikëqyrja ajrore e NATO-së nuk mund të garantonin zbatimin e marrëveshjes³⁸”.

³⁶ Petrisch, Wolfgang, “Kosova dhe bashkësia ndërkombëtare”, Shtëpia botuese Koha ditore 2002, Prishtinë, 135f

³⁷ Petrisch, Wolfgang, “Kosova dhe bashkësia ndërkombëtare”, Shtëpia botuese Koha ditore, Prishtinë, 2002, 138f

³⁸ Judah, Tim, “Kosovo: War and Revenge”, Shtëpia botuese Yale university books, 2005, 455f

Në këtë gjendje të krijuar e vetmja menyrë ti dilej përpara kësaj situatë ishte arritja që krijohet një grup brenda kampit kosovar i aftë për të zhvilluar bisedime. Pas dështimit të përpjekjeve të amerikanëve për të veçuar njerëz me peshë në gjirin e UÇK-së me të cilët do të hyhej në bisedime, që nga vera e vitit 1998 nën drejtimin e Petriqit u bënë hetimet jozyrtare për personalitetet udhëheqëse të UÇK-së. Pas një hulumtimi disi të gjatë, grupi i Hashim Thaqit u veçua si partneri më i përshtatshëm për bisedimet e ardhshme.

Ngjarjet, të cilat quan në shkallëzimin vendimtarë të mbarëkonfliktit, zunë fill me 8 janar, kur njësitët e UÇK-së vranë tre policë serbë pranë Shtimjes. Tri ditë më pas në një fshat të afërm u vra edhe një policë serb. Beogradi reagoi ndaj kësaj ngjarje duke dërguar trupa dhe armatime në zonë. Në mëngjesin e 15 janarit shpërthyen luftime ndërmjet njësiteve të UÇK-së dhe njësiteve jugosllave pranë Reqakut. Në mëngjesin e ditës tjetër KVM-ja njoftoi se kishte gjetur 45 kufoma shqiptarësh, kryesisht civilë. Midis tyre ishin tri gra, një fëmijë dhe shumë pleq. Këtë ngjarje Uollkeri (drejtuesi i misionit KVM-së) e cilësoi qartë dhe hapur si krim ndaj njerëzimit.

Bashkësia ndërkombëtare e cila në vlerësimin e ngjarjeve të Reqakut u nis nga deklarata zyrtare e OSBE-s, me anë të një note drejtuar qeverisë të Beogradit shprehu indinjatë dhe neveri ndaj veprimeve të forcave serbe.

Nën drejtimin e Petriqit ambasadorët e Trojkës së BE-së së drejtuar nga Gjermania dhe të Grupit të Kontaktit menjëherë pas ngjarjes i paraqiten ministrisë së jashtme jugosllave një notë proteste. Në të dënohej shumë ashpër sulmi i forcave të sigurisë kundër popullsisë civile dhe kërkohesh sqarimi i plotë i ngjarjes në bashkëpunim me Gjykatën ndërkombëtare për krimet e luftës në Hagë.

Pamjet e viktimave të masakrës ngjallën indinjatë të madhe në botën perëndimore. Menjëherë u zgjuan kujtimet e ngjarjeve të Bosnja e Hercegovinës. Për të gjithë u bë e qartë se duhet vepruar menjëherë ndërsa SHBA-ja ishte për një goditje të menjëhershme ushtarake, përfaqësuesit e tjerë të Grupit të Kontaktit dhe të BE-së zgjodhën fillimin e

bisedimeve më të gjera për zgjidhjen e çështjes së Kosovës dhe vënien e menjëhershme në jetë të rezultateve të bisedimeve.

Të dyja palëve iu kërkua që të përgatiteshin për bisedime me pjesëmarrje të drejtpërdrejtë ndërkombëtare në një vend që do të përcaktohej. Problem kryesor vazhdonte të mbetej krijimi i një grupi bisedues kosovaro-shqiptar që të përfshinte të gjitha grupimet e rëndësishme. Ministri jashtëm Britanik Kuk së bashku me dy ndërmjetësuesit kryesor Petriq dhe Hill ishin drejtues të iniciativës për përfshirjen e përfaqësuesve të tri fraksioneve politike më të rëndësishme të shqiptarëve të Kosovës, për ti bindura ata për rëndësinë e pjesëmarrjes në konferencën e paqes. Ibrahim Rugova dhe Rexhep Qosja pranuan këtë rol ndërsa Adem Demaqi e refuzoi. Më në fund u bë miratimi i Hashim Thaqit për pjesëmarrje në konferencë.

4.1 KONFERENCA E RAMBUJESË

Është vendosur që konferenca të mbahet në Rambuje afër Parisit. Grupi i Kontaktit kishte vendosur që faza e parë e bisedimeve do të kushtohej vetëm pjesës politike të marrëveshjes, e cila ishte mjaftë komplekse dhe vendimtare në vështirimin afatgjatë. Vetëm pas arritjes së marrëveshjes për këtë pjesë do të diskutohej për zbatimin dhe për çështjet e sigurisë. Reagimi i parë i shqiptarëve ishte në lidhje me mungesën e klauzolës së referendumit për pavarësi. Ata gjithashtu kërkuan garanci të gjërë dhe të përgjithshme ndërkombëtare për siguri. Me këtë garanci kuptohej prania e NATO-s si instancë ushtarake e zbatimit dhe nënshkrimi i marrëveshjes nga përfaqësuesit e Grupit të Kontaktit. “Por delegacioni Serb nuk kishte dhënë as një shenjë qëndrimi konstruktiv në diskutimin e marrëveshjes³⁹”.

Për kosovarët referendumi për pavarësi dhe çmilitarizimi i UÇK-së ishin dy çështje që nuk viheshin në diskutim. Për republikën federative të Jugosllavisë një forcë ushtarake nën drejtimin e NATO-s nuk mund të pranohej në asnjë rrethanë në territorin e saj. Për ti dal përpara dështimit të konferencës duhej gjetur sa më shpejt një rrugëdalje. Kjo mund

³⁹ Milo, Prof. Dr., Paskal, “Ditari i një ministri të jashtëm”, Toena, Tiranë, 2008, 237f

të arrihej vetëm duke shtuar trysninë mbi të dyja delegacionet dhe duke intensifikuar bisedimet.

Ndërkohë BE-ja nën drejtimin e presidencës Gjermane kishte hartuar një plan të hollësishëm që përmbante hapat dhe kalendarin e saktë kohor të heqjes së sanksioneve ndaj Jugosllavisë. “Plani i BE-së do ty hynte në fuqi në ditën e nënshkrimit të marrëveshjes së Rambujesë⁴⁰”. Edhe pas bisedimeve të gjata dhe këmbëngulëse në mes të ndërmjetësuesve të BE-së dhe përfaqësuesve Serb, këto përpjekje nuk dhanë frytë.

Në Rambuje u trajtua 95% e pjesës politike të marrëveshjes. Por edhe pjesa tjetër prej 5% ishte trajtuar gjerësisht më parë. Pas kësaj Grupi i Kontaktit, sipas këshillës së tre ndërmjetësuesve, vendosi ndërprerjen e bisedimeve deri më 15.mars. Ishte e qartë që në këtë datë edhe pjesa mbi zbatimin e marrëveshjes duhet të ishte diskutuar dhe e gatshme për nënshkrim. Ndërkaq në Beograd do të sqaroheshin çështjet e mbetura pezull me delegacionin serb. Me këtë, delegacionit shqiptar të Kosovës iu dha mundësia të vinte në dijeni popullsinë mbi marrëveshjen. Grupi i Kontaktit vendosi që në asnjë mënyrë të mos pranonte as një ndryshim të marrëveshjes.

Bisedimet e Rambujesë u vazhduan në Paris. Sjellja e pales serbe karakterizohej me një cinizëm dhe arrogancë, që çdo diskutim bëhej qe në fillim i pamundur⁴¹. Ishte e qartë se ata kishin ardhur me synimin për ti rënë ndesh çdo propozimi të ndërmjetësuesve ndërkombëtar.

Krejt ndryshe ishte qëndrimi i kosovarëve. Që në fillim ata shprehën miratimin për të gjithë projektin e marrëveshjes. Delegacioni kosovarë ishte tërreësisht i vendosur për të nënshkruar marrëveshjen. Në mbrëmjen e 18 marsit shqiptarët e Kosovës nënshkruan marrëveshjen me një ceremoni të thjeshtë, pa fjalime dhe deklarata. “Serbet nuk treguan gatishmëri për të drejtuar procesin përpara⁴²”.

⁴⁰ http://sq.wikibooks.org/wiki/Dokumenti_i_Rambujes%C3%AB

⁴¹ Glenny, Misha, “The Balkans – nationalism, war and great powers” Granta books, 1999, 111f

⁴² Milo, Prof. Dr., Paskal, “Ditari i nje ministri jashtem”, Toena 2008, Tiranë, 308f

Kryesuesi i OSBE-s njoftoi për tërheqjen e misionit verifikues nga Kosova. Si shkak është përmendur dështimi i bisedimeve në Paris dhe mungesa e garancisë të sigurisë të vëzhguesve. Njëkohësisht me tërheqjen e KVM-s nga Kosova filloi edhe evakuimi i personelit të ambasadave perëndimore nga Beogradi.

Menjëherë sapo u bë e ditur shtyrja e bisedimeve të Parisit filluan bisedimet intensive për vazhdimin e mëtejshëm të punës së Grupin të Kontaktit. SHBA-ja kishte në plan të dërgonin në Beograd Hollbrukun me një paralajmërim të fundit për një goditje ushtarake të menjëhershme. Përkundrazi Rusia propozoi një përpjekje të fundit për bisedime me Millosheviqin.

Takimi me Millosheviqin u mbajt me 22 mars në selinë e presidentit Jugosllavë. Takimi u ndërpre pas më shumë se tri orë bisedime të pafrytshme. Në pasditen e 23 marsit u bë e mundur të konstatohej vetëm dështimi i përpjekjeve diplomatike. Në mbrëmjen e 24 marsit filloi sulmi i parë i NATO-së ndaj Jugosllavisë.

4.2 KONFLIKTI NË HORIZONT

Për herë të parë në historinë e vet, NATO-ja po hynte në luftë. Me valën e parë të sulmeve kundër Jugosllavisë u dendësua edhe terrori kundër popullsisë shqiptare të Kosovës. Dëbimi i organizuar mbërtheu tashmë edhe Prishtinën dhe qytetet e tjera të Kosovës. Fatin tragjik të profesorit Fehmi Agani, këshilltarit të urtë të Rugovës, njeriut të kompromisit dhe të tolerancës tregoi edhe një herë që shpresat për pajtim janë të vogla.

Gjatë bombardimeve dhjetë javësh të NATO-s veprimtaria e organizatave ndërkombëtare u zhvendos drejt shërbimeve ndihmëse humanitare dhe diplomatike. Përfaqësuesi i BE-së vizitoi kampet e refugjateve shqiptarë të Kosovës në Maqedoni dhe Shqipëri.

Mosmarrëveshjet mbi ligjshmërinë e ndërhyrjes së NATO-s në bazë të së drejtës ndërkombëtare ose kritika ndaj saj, dilema ndërmjet të drejtave të njeriut dhe sovranitetit

shtetëror, debat i lindur prej rastit të Kosovës mbi pamjaftueshmërinë e procedurave ekzistuese të Këshillit të Sigurimit, në mënyrë të një vërshimi diskutimesh nga mediat dhe dijetaret.

Në Petersburg pranë Bonit u hartuan elementet e një iniciative Euro-Ruse për përfundimin e luftës. Ish kryeministri rus Viktor Cerdomirdin dhe ish presidenti finlandez Martti Ahtisaari u dërguan në Beograd me një propozim të panegociueshem për përfundimin e ndërhyrjes së NATO-s. Kjo iniciativë që në vizitën e parë arriti sukses. Pas 78 ditësh lufte Millosheviqi u dorëzua.

4.3 ÇLIRIMI I KOSOVËS

Më 9 qershor 1999 në Kumanovë të Maqedonisë NATO-ja e nënshkroi marrëveshjen tekniko-ushtarake⁴³ e cila mundësoi mbarimin e luftës dhe i mundësoni koalicionit më të fuqishëm ushtarak që bota kishte parë ndonjëherë të dislokohej në Kosovë pa pengesa. Qeveria e Serbisë ishte pajtuar që t'i tërhiqte forcat nga Kosova gradualisht për 11 ditë.

Me 10 qershor 1999, Kosova u vu nën kujdestarinë e bashkësisë ndërkombëtare. Po atë ditë Këshilli i Sigurimit i OKB-së e miratoi Rezolutën 1244⁴⁴ duke e themeluar Misionin e Administratës së Përkohshme të OKB-së në Kosovë, apo UNMIK-un. Misionit iu dha mandati për t'i udhëhequr të gjitha aspektet e administratës civile, për të themeluar institucionet demokratike të nevojshme për vetëqeverisje substanciale dhe për të krijuar bazën për zgjidhjen përfundimtare të statusit të kontestuar politik të Kosovës.

⁴³ http://vetevendosje.org/sh/images/stories/Gazeta/MTA_Kumanova.pdf

⁴⁴ <http://daccess-dds-ny.un.org/doc/UNDOC/GEN/N99/172/89/PDF/N9917289.pdf?OpenElement>

5. ADMINISTRIMI NDËRKOMBËTAR NË KOSOVË

Edhe pse thuhet se Aleanca Perëndimore “ka fituar” në konfliktin e Kosovës, fushata e bombardimeve të NATO-s nuk ka përfunduar me kapitullimin e pakusht të Jugosllavisë, por si kompromis i negociuar që u reflektua në mandatin e UNMIK-ut. Rezoluta e KS të OKB-s 1244, e akorduar midis SHBA-së, Ruisë, dhe anëtarëve të tjerë të KS-s në qershor të vitit 1999, nuk i trajtonte çështjet më të rëndësishme të mospajtimit: a duhej bërë Kosova shtet i ri sovran; roli i saktë i Beogradit dhe i serbëve të Kosovës në administratën e re të Kosovës; dhe kohëzgjatja e këtyre ujdive të përkohshme.

OKB-së nuk iu dha vetëm përgjegjësia e administrimit në Kosovë por iu dha përparësi edhe ndaj partnerëve të vet të koalicionit. Këta ishin tre-Komisariati i Lartë i OKB-së për Refugjatë (UNHCR) që u mor me emergjencën humanitare; OSBE-ja që e udhëhoqi Misionin Verifikues për Kosovën para luftës dhe tani e kishte mandatin për t’i zhvilluar të drejtat e njeriut, demokracinë dhe institucionet shoqërore bashkëkohore; dhe Bashkësia Evropiane, përgjegjëse për ekonominë te.

UNMIK-u ishte një mision me qëllim kryesor të ndihmonte vendosjen dhe mbajtjen e paqes dhe rindërtimin dhe instalimin e sundimit të ligjit në territorin e shkatërruar ku mbizotëronte anarkia. Një prej mënyrave të mbajtjes së paqes ishte edhe transferimi i kompetencave dhe të përgjegjësive te organet vendore. Organi i parë qeverisës Këshilli i Përkohshëm është formuar nga UNMIK-u me pjesëmarrje të një spektri gjithëpërfshirës politik në Kosovë, duke e përfshirë edhe komunitetin serb. Megjithëse, ky organ nuk pati shumë përgjegjësi në procesin e vendimmarrjes ishte gurthemel për institucionet e para të përbashkëta vetëqeverisëse të Kosovës.

UNMIK-u përmes zyrës kryesore të tij, zyrës së Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP), vazhdoi të miratoi rregullore të cilat i zëvendësuan ligjet e mëparshme në Kosovë.

Por prapë roli kryesor i UNMIK-ut ishte koordinimi i reagimeve dhe intervenimeve të bashkësisë ndërkombëtare në ngjarjet në Kosovë. PSSP-ja kishte takime të rregullta me

zyrat e Kuintit dhe Grupit të Kontakt. Edhe pse prania e bashkësisë ndërkombëtare ishte enorme, UNMIK-u këtë rol e ka kryer me sukses.

Një hap përpara drejt konsolidimit të institucioneve të vetëqeverisjes ishte edhe miratimi i Kornizës Kushtetuese e cila ishte bazë për organizimin dhe ndarjen e degëve qeverisëse në Kosovë.

Edhe pse të para në mënyrë sipërfaqësore këto veprime dukeshin të duhura dhe kanë sjell përmirësime në jetën publike të Kosovës, në brendi ishin të brishta dhe nuk paraqitnin asnjë ndryshim rrënjësor dhe qëndrueshëm për Kosovën.

Bashkësia ndërkombëtare në Kosovë zgjodhi rrugën e lehtë dhe vendosi të jetë pasive⁴⁵. Kjo kishte një efekt negativ te popullsia e Kosovës e cila, pas të gjitha fatkeqësive të luftës kishte pritur zhvillime të reja pozitive dhe zgjidhje më të shpejta të gjendjes.

Kjo rezultoi në dhunë masive ndëretnike në marsin e vitit 2004. Ky zhvillim e zgjoi bashkësinë ndërkombëtare në Kosovë dhe e shtyu UNMIK-un që të hapte debatin për statusin final të Kosovës. Duke pasur parasysh gjendjen e komunitetit Serb dhe të drejtën e vetos të Rusisë në Këshillin e Sigurimit, debati i statusit u kushtëzua në tetë standarde që duheshin të plotësoheshin nga institucionet e Kosovës para se të hapej çështja e statusit.

PSSP-ja në emër të Kosovës raportoi dy herë në vit para Këshillit të Sigurimit mbi përmbushjen e standardeve para statusit. Diplomati norvegjez Kai Aide⁴⁶ ishte përfaqësues i bashkësisë ndërkombëtare i mandatuar nga Këshilli i Sigurimit që të përcillte gjendjen në Kosovë në krahasim me standardet e përcaktuara nga bashkësia ndërkombëtare. Me përmirësimin e performancës së Kosovës në përmbushjen e standardeve ishte rritur edhe numri i kompetencave të bartura nga UNMIK-u te Qeveria e Kosovës.

⁴⁵ Judah, Tim, "Kosovo: War and Revenge", Shtëpia botuese Yale university books, 2005, 147f

⁴⁶ <http://www.unosek.org/docref/KaiEidereport.pdf>

5.1 STATUSI SI ZGJIDHJE E VETME QËNDRUESHME

Kosova vazhdonte të tregonte rezultate në përmbushjen e standardeve gjë e cila e shtyu OKB-në dhe bashkësinë ndërkombëtare në Kosovë të ndihmojnë procesin e hapjes së bisedimeve mes të Prishtinës dhe Beogradit.

Nën kryesimin e Presidentit të Kosovës, Ibrahim Rugova, në Prishtinë u formua Ekipi i Unitetit, anëtarë të së cilit u bënë përfaqësuesit e partive politike, intelektualë të shquar dhe pjesëtarët e minoriteteve, duke i përjashtuar serbët e Kosovës.

Kjo përpjekje është udhëhequr nga OKB-ja në koordinim të ngushtë me BE dhe Grupin e Kontaktit. Shtetet e Bashkuara të Amerikës ishin shteti më i zëshëm i cili proklamonte rëndësinë e vendosjes së statusit për stabilitet rajonal. Pikërisht SHBA-të ishin sponsorizuese kryesore të procesit të statusit të kryesuar nga ish Presidenti i Finlandës Marti Ahtisari.

Me një vendim të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, Marti Ahtisari u emërua Përfaqësues i Posaçëm i Kombeve të Bashkuara për statusin e Kosovës. Zyra e Z. Ahtisari ishte e stacionuar në Vjenë ku janë mbajtur të gjitha takimet në mes të dy palëve negociuese.

Bisedimet në Vjenë nuk rezultuan me një zgjidhje të pranuar nga të dyja palët. Kjo përpjekje u vazhdua edhe nga një ekip trepalësh negociator i kryesuar nga përfaqësues të BE-së, SHBA-ve dhe Ruisë. Ky vazhdim i negociatave ishte bere per tu knaqur Serbi dhe per te futur edhe Rusine si faktor ne zgjidhje te problemit. Edhe ky vazhdim i negociatave nuk dha rezultat.

Megjithatë, koha e paraparë për bisedime kaloi dhe Ahtisari u desh që ta prezantojë punën e vet para Këshillit të Sigurimit. Ai e paraqiti punën e bërë në formën e Dokumentit Gjithëpërfshirës për Statusin Final të Kosovës. Ky dokument sugjeronte

pavarësinë si zgjidhjen e vetme për statusin me disa dispozita mbrojtëse për komunitetin serb në Kosovë⁴⁷. Dokumenti sugjeronte pavarësi por të mbikëqyrur nga bashkësia ndërkombëtare.

5.2 BASHKËSIA NDËRKOMBËTARE NË PRITJE TË PAVARËSISË SË KOSOVËS

Propozimi i Ahtisarit nuk u votua në Këshillin e Sigurimit. Rusia dhe Kina përdorën të drejtën e vetos. Vetoja ishte vene për arsye se shmangjes e hapjes së precedentit ligjor, gje nga e cila frikoheshin të dy shtete për arsye të problemeve interne që kishin (Rusia me Qeqenine dhe Kina me Tibet). Kjo e komplikoi çështjen e zgjedhjes së statusit dhe aranzhimet e bashkësisë ndërkombëtare në Kosovë, por nuk i bëri ato të pamundura. Me shpalljen e dokumentit të Ahtisarit në Prishtinë u formuan dy zyra të reja ndërkombëtare, ajo e EULEX-it⁴⁸ (i krijuar nga Këshilli i Ministrave të BE-së) dhe Zyra Civile Ndërkombëtare (e krijuar nga BE me kontribut të madh nga SHBA-të).

Këto dy zyra e koordinuan dhe e ndihmuan Kosovën në kryerjen e detyrave të caktuara në dokumentin e Ahtisarit. Këto detyra (në formë të ligjeve me qëllim të garantimit të drejtave të komunitetit serb) ishin kushte të cilat Kosova është dashur t'i përmbushë në shkëmbim për njohjen ndërkombëtare të pavarësisë së saj. Këto dy zyra të reja krijuan raporte të mira me institucionet e Kosovës dhe në masë e konsiderueshme e zëvendësuan ndikimin e UNMIK-ut.

⁴⁷ <http://www.ico-kos.org/d/Ahtisaari%20Comprehensive%20Proposal%20in%20English.pdf>

⁴⁸ http://www.eulex-kosovo.eu/home/docs/JointActionEULEX_EN.pdf

6. SHPALLJA E PAVARËSISË

Në koordinim të ngushtë me zyrat e Kuintit Kosova me 17 shkurt 2008 shpalli pavarësinë e saj⁴⁹. Në ditët e para pas pavarësisë shumica nga vendet e BE-së duke i përfshirë edhe SHBA-të e njohën pavarësinë e Kosovës. Kjo nuk ndodhi me katër shtete të BE-së (Greqi, Sllovaki, Qipro dhe Spanjë) të cilat nuk i përcollën shtete tjera. Këshilli i Ministrave të BE-së i bëri thirrje të gjitha shteteve të BE-së të pranojnë realitetin e ri në Kosovë dhe të ndihmojnë procesin e integritit të Kosovës në strukturat euroatlantike.

Shtetet të cilat nuk e njohën Kosovën, e bënë këtë për arsye të brendshme, ose për arsye të miqësisë së fortë dhe raporteve të mira tradicionale me Serbinë. Kjo e bëri procesin e integritimeve euroatlantike shumë të vështirë dhe të komplikuar, sepse shumica e vendimeve në lidhje me zgjerimin merren me konsensus. Kjo e bëri procesin e negociatave për zgjerim dhe kandidaturë të Kosovës shumë të ndërlikuar.

Në bazë të rregullave të BE-së hapi i parë drejt integritit është nënshkrimi i stabilizim asociimit i cili duhet të ratifikohet nga parlamente të gjitha shteteve anëtare. Pasi që jo të gjitha shtetet e kanë njohur pavarësinë as kjo marrëveshje nuk ishte e mundur të nënshkruhej. Ky është vetëm një shembull i pengesave formale dhe reale të cilat e pengojnë procesin e mëtutjeshëm të Kosovës në rrugën drejt bashkimit në familjen e shteteve evropiane.

Me praninë e NATO-së përmes KFOR-it si garantues i paqes dhe stabilitetit në vend, dhe me forca ushtarake të Kosovës ende të brishta dhe të papërgatitura, aspiratat për anëtarësim në NATO nuk duket që mundën të arrihen lehtë. Forcat e sigurisë të Kosovës të formuara në bazë të Pakos së Ahtisarit janë në fazën e parë të konsolidimit të tyre dhe ende nuk e kanë arritur nivelin e përgatitjes dhe gatishmërisë të përcaktuar si kriter për anëtarësimin në NATO. Mosnjohja e pavarësisë së Kosovës nga disa shtete anëtare të

⁴⁹ <http://www.kosova.com/artikulli/44461>

NATO-së paraqet një pengesë politike për integrimin dhe anëtarësimin e shtetit të Kosovës në këtë aleancë ushtarake.

Në përpjekjet e saj për të ngadalësuar njohjen e Kosovës nga shtete anëtare të OKB-së në nëntor të vitit 2009 Serbia e paraqiti kërkesën për shqyrtimin e ligjshmërisë së shpalljes së pavarësisë të Kosovës nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë⁵⁰. Shtetet e interesuara kanë pasur mundësi të paraqiten pro ose kundër pavarësisë të Kosovës. Pritet që Gjykata të dalë me një vendim i cili do të ishte shume neutral dhe i vështirë për t'u interpretuar. Vendimi i Gjykatës nuk do të jetë paragjykes dhe do të varet nga interesi i shtetit dhe ndikimi i shteteve të mëdha se çfarë do të vendosin shtetet të cilat ende nuk janë deklaruar për këtë çështje.

Edhe përkundër të gjitha pengesave Kosova deri tani ka arritur të bëhet anëtare e Bankës Botërore dhe Fondit Ndërkombëtar Monetar dhe siguroi qasje në fonde dhe ndihma të konsiderueshme për zhvillim mëtutjeshëm të Kosovës.

⁵⁰ <http://www.icj-cij.org/docket/files/141/14797.pdf>

7. DESTINACION I FUNDIT – INTEGRIMET EVROPIANE DHE DIPLOMACIA KOSOVARE

Të gjitha arritjet e deritashme janë meritë e diplomacisë së re kosovare e cila për një kohë të shkurt arriti të shtrihet globalisht dhe bashkësisë ndërkombetare e cila pati ndikim në mbrojtjen dhe arsyetimin e ligjeshmerise se pavaresise te shpallur nga institucione legjitime te Kosoves. Ministria e punëve të jashtme (MPJ) e Kosovës ishte e ngarkuar të koordinoj dhe të udhëheq mbrojtjen e rastit të Kosovës në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë. Përveç kësaj MPJ ka arritur të hapë më shumë se 20 përfaqësi diplomatike të shtetit të Kosovës në shtete të cilat e kanë njohur pavarësinë e vendit. Sfida kryesore e kësaj diplomacie të brishtë është edhe mungesa e kuadrove të kualifikuar dhe mungesa e traditës në këtë fushë veprimi.

Edhe përkundër këtyre sfidave Kosova tani ka një shans të ndërtojë një shërbim diplomatik modern dhe të shfrytëzojë ndihmën ndërkombëtare dhe resurset e huaja diplomatike në vend.

Suksesi i diplomacisë kosovare nuk varet vetëm nga arritjet e brendshme por në një masë të madhe edhe nga zhvillimet ndërkombëtare, posaçërisht nga lëshimet e BE-së dhe zbutja e qëndrimeve të shteteve anëtare të BE-së të cilat nuk pranojnë të njohin pavarësinë e Kosovës.

Përafrimi i Kosovës me BE-në ka ngecur edhe nga ndikimi i Serbisë si të serbët në Kosovë ashtu edhe të shtetet e BE-së të cilat tradicionalisht kanë raporte miqësore me Serbinë. Një tryzni konstruktive mbi Serbinë do të ishte e domosdoshme dhe e nevojshme për të mundur integrimin e Kosovës në familjen evropiane dhe do të mundësonte parandalimin e izolimit të popullit të Kosovës dhe krijimin e një ishulli të izoluar në qendër të Ballkanit.

8. L I T E R A T U R A

Noel Malcolm *Kosovo: A Short History* (1998)

Paskal Milo "Ditari i nje ministri te jashtem" (2008)

Esat Stavileci, "Sistemi i delegateve", Rilindja, (1980)

Misha Glenny "The Balkans – nationalism, the war and great powers" Granta books, 1999

Iain King and Whit Mason "Peace at any price" (2006 e publikuar nga Cornell University Press)

Mark Weller "Contested Statehood: Kosovo's Struggle for Independence" (Hardcover - May 15, 2009)

Wolfgang Pietrisch "Kosova dhe bashkësia ndërkombëtare" (Koha Ditore, 2002)

Tim Judah "Kosovo: War and Revenge" Paperback (2005)

Erić, Slobodan i Marić, Ivan, "Zoran Djindjic o Kosovu", Udruzenje knjizevnika "Cer", Beograd, 2003

Buxhovi, Pr., Jusuf, "Kthesa historike – Lufta e perëndimit për Kosovën", Shtëpia botuese Faik Konica, Prishtinë, 2009

H. Perrit, Henry, "The history of an insurgency", Chicago Kent College, 2008

Howard Clarck, "Civil Resistance in Kosovo" Pluto press, 2000

James, Petiffer, "Kosovo Express" C. Hurst & Co Ltd, 2005

James, Petiffer, "The Albanian Question: Reshaping the Balkans", I.B. Taurus & Co Ltd, 2006

Misha Glenny <http://www.prospectmagazine.co.uk/2008/04/youbrokeityouownit/>

Deklarata e Këshillit të Ministrave të BE-së

www.council.eu

International Crisis Group

http://www.crisisgroup.org/home/index.cfm?action=conflict_search&l=1&t=1&c_country=58

Raportet e UNHCR-së të viteve 1997, 1998 dhe 1999

www.unhcr.org

Rezolutat e OKB-së

www.un.org/resolutions

Deklaratat e Grupit të Kontaktit

www.statedepartment.gov

Raporti i të dërguarit të posaqëm për vlerësimin e përmbushjes së standardeve Kai Aides

www.un.org

Deklarata e Sekretarit të përgjithshëm të NATO-së

<http://www.nato.int/docu/pr/1998/p980924e.htm>